



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. 36886 Prot.

Tiranë, më 12.11.2016

URDHËR

Nr. 29, Datë 10/11 /2016

PËR
“DELEGIMIN E FIRMËS”

Në mbështetje të nenit 17, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nenit 26 të Ligjit nr. 90, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; nenet 28 dhe 29, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe nenit 21, të Ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Z. Enkel Musaj, me detyrë Drejtor i Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, autorizohet për marrjen, shpërndarjen e shkresave zyrtare hyrëse nëpërmjet protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të cilat lidhen me informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, si edhe delegimin e të drejtës së firmës për nënshkrimin e shkresave dalëse lidhur me sa më sipër.
2. Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të marrë masat për publikimin e këtij Urdhëri në faqen zyrtare të internetit: www.tatime.gov.al. ✓
3. Ngarkohen për zbatim të këtij urdhri, Z. Enkel Musaj dhe Zyra e Protokollit.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

SAJDIKA VJERO

